



AGJENCIA E MBIKËQYRJES TË SIGURIMEVE

**Raporti Vjetor i Punës së Agjencisë së Mbikëqyrjes të
Sigurimeve për vitin 2023**

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2.1. PUNA E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE	3
2.1. MISIONI DHE VIZIONI	4
2.2. VLERAT	4
2.3. STRATEGJIA PËR MENAXHIMIN E RREZIQEVE	4
2.4. PLANIFIKIMI I PUNËS SË AMS-SË	5
2.5. AUDITIMI I BRENDSHËM	5
2.6. ORGANIZIMI DHE FINANCIMI I AMS-SË	5
2.7. PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE KORPORATIVE	6
3. AKTIVITETE TË REALIZUARA NË PERIUdhËN E RAPORTIT SIPAS FUSHAVE	6
3.1. RREGULLATIVA DHE LICENCIMI	7
3.2. RREGULLORE, UDHËZIME DHE MANUALE TË MIRATUARA	7
3.2. LICENCA TË DHËNA	8
3.3. LICENCA TË REVOKUARA	9
3.4. TRAJNIME TË ORGANIZUARA	9
4. ZBATIMI I MBIKËQYRJES	9
4.1. MBIKËQYRJE NË TERREN	9
4.2. MBIKËQYRJE OFF-SITE	10
4.3. PJESËMARRJE NË KOLEGIUME PUNE	10
4.4. PIKËPAMJE DHE QARKORE	10
5. BASHKËPUNIMI	11
6. ORGANIZIMI I EVENTEVE	13
7. EDUKIMI DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE	17
8. MBROJTA E KONSUMATORËVE, EDUKIMI FINANCIAR DHE PËRFSHIRJA FINANCIARE	17
9. AKTIVITETE PROJEKTUESE	16
10. INFORMIMI I PUBLIKUT DHE TRANSPARENCA	16

1. Hyrje

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (emërtimi i shkurtuar **AMS**) është trup rregullator i pavarur, që normativizon tregun e sigurimeve, zbaton mbikëqyrjen e aktivitetit të subjekteve të sigurimeve, kujdeset që të mbrojnë të drejtat e policëmbajtësve dhe kontribuon në edukimin dhe përfshirjen financiare të popullatës.

Puna e AMS-së përcaktohet me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2002, 98/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 112/2011, 188/2013, 30/2014, 43/2014, 112/2014, 153/2015, 192/2015, 23/2016, 83/2018 dhe 198/2018) dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/2019, 31/2020 dhe 173/2022), dhe me Ligjin për Sigurim të Detyrar në Transport me nr. 88/2005, 70/2006, 81/2008, 47/2011, 135/2011, 112/2014 dhe 145/2015 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/2019).

➤ ***Në realizimin e qëllimeve për të cilat është themeluar, AMS-ja ka këto kompetenca ligjore:***

- Jep dhe revokon leje, dakordime dhe licenca;
- Zbaton mbikëqyrje të shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit në sigurime, shoqërive të përfaqësimit në sigurime, bankave të cilat ushtrojnë aktivitete të përfaqësimit në sigurime, brokerëve të sigurimit dhe përfaqësuesve në sigurime, të personave juridikë që lidhen me shoqëritë e sigurimeve dhe të Byrosë Nacionale të Sigurimeve;
- Shqipton masa të mbikëqyrjes në formë të urdhrave dhe aktvendimeve;
- Miraton akte nënligjore për zbatim të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve dhe jep propozime për ndryshime dhe plotësime të ligjeve nga fusha e sigurimeve;
- I mbron të drejtat e konsumatorëve dhe proceduron lidhur me ankesat e parashtruara nga të siguruarit; përdoruesit e sigurimeve dhe palëve të treta të dëmtuara;
- Stimulon zhvillimin dhe rritjen e tregut të sigurimeve duke rritur ndërgjegjësimin e publikut për rolin e sigurimeve, kryen aktivitete të edukimit financiar dhe përfshirjes financiare, ruan stabilitetin e tregut të sigurimeve dhe kontribuon në forcimin e besimit të opinionit publik;
- Bashkëpunon me institucionet dhe trupat relevantë të vendit dhe të huaj;

2. Menaxhimi institucional

2.1. Puna e Këshillit të Ekspertëve

Organi Drejtues i AMS-së është Këshilli i Ekspertëve, i cili përbëhet nga pesë anëtarë. Tre anëtarë janë të angazhuar profesionalisht me orar të plotë pune në AMS, prej të cilëve njëri është Kryetar i Këshillit, ndërsa dy janë anëtarë të angazhuar joprofesionalisht.

Anëtarët e Këshillit të Ekspertëve emërohen dhe shkarkohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me Propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në pajtim me Vendimin e Kuvendit të RMV-së, anëtarë të Këshillit të Ekspertëve janë:

- Dr. Kërste Shajnoski, i angazhuar profesionalisht me orar të plotë pune, Kryetar i Këshillit të Ekspertëve

- Dr. Sulejman Ahmedi, anëtar i angazhuar profesionalisht në Këshillin e Ekspertëve, me orar të plotë pune,
- Zllate Simonovski, anëtar i angazhuar profesionalisht në Këshillin e Ekspertëve, me orar të plotë pune,
- Dr. Igor Ivanovski, anëtar i Këshillit të Ekspertëve, i cili nuk është i angazhuar profesionalisht,
- Aleksandra Kokaroska, anëtare e Këshillit të Ekspertëve, e cila nuk është e angazhuar profesionalisht.

Këshilli punon dhe vendos në seanca, merr vendime me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Puna e Këshillit të Ekspertëve, mënyra e mbajtjes së seancave dhe marrja e vendimeve rregullohen në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, Statutin e AMS-së dhe Rregulloren e Punës së Këshillit të Ekspertëve.

Gjatë vitit 2023, Këshilli i Ekspertëve ka mbajtur 35 seanca në të cilat ka vendosur për çështje nga fushëveprimi dhe kompetencat e tij.

Agjencia e Mbikëqyrjes të Sigurimeve për punën e vet mban përgjegjësi para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kuvendi miraton: Planin financiar të AMS-së, Raportet financiare të rishqyrtuara nga një auditues i pavarur i autorizuar, Raportin vjetor për punën e AMS-së dhe Raportin vjetor mbi gjendjen dhe lëvizjen e tregut të sigurimeve.

2.1. Misioni dhe vizioni

Misioni dhe vizioni i AMS-së synon zhvillimin e tregut të sigurimeve me qëllim të mbrojtjes më të madhe të të drejtave të të siguruarve, rritjen e ndërgjegjësimit për sigurimin dhe forcimin e besimit në subjektet e tregut, sigurimin e stabilitetit të sistemit financiar si pjesë e sistemit të përgjithshëm financiar.

Pjesë e misionit dhe vizionit të AMS-së është zbatimi i politikës së cilësisë dhe bazohet në ngritjen edhe mirëmbajtjen e proceseve për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së punës së saj. AMS-ja ka një certifikatë për menaxhimin me cilësinë në përputhshmëri me kërkesat e standardit të ISO 9001: 2015 - Menaxhimi i Cilësisë.

Politika e cilësisë është pjesë integrale e misionit tonë dhe është në përputhje me kërkesat e standardit ISO 9001:2015 – Sistem Menaxhimi Cilësor. Me marrjen e rregullt të Certifikatës së Cilësisë, AMS-ja konfirmon aplikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të një sistemi efikas të menaxhimit të cilësisë.

2.2. Vlerat

Parimet dhe vlerat themelore nga të cilat ne udhëhiqemi janë: **përgjegjësia, profesionalizmi, ndërgjegjësimi dhe transparenca.**

2.3. Strategjia për menaxhimin e rreziqeve

Strategjia për menaxhimin me rreziqet në AMS është mekanizmi ynë për menaxhimin me sukse të rreziqeve, me qëllim që të parashihen ngjarjet e papërshtatshme dhe të reagohet ndaj tyre në kohë, përkatësisht të jepen procedurat e kontrollit të brendshëm dhe resurset për funksionet kyçe dhe rreziqet që lidhen me to. Një nga segmentet në këtë kuadër është sistemi i integritetit. Në këtë kuadër, në vazhdimësi kryhen aktivitete për mirëmbajtjen e të gjithë pajisjeve të IT-së dhe sistemeve të informacionit të AMS-së.

2.4. Planifikimi i punës së AMS-së

Aktet strategjike, planet operative, aktet nënligjore dhe lloje të tjera aktesh, AMS-ja i sjell përmes procesve të analizave dhe planifikimit duke pasur parasysh rrethanat, faktorët e brendshëm dhe ndikimin e tyre në arritjen e objektivave dhe detyrave të planifikuara.

Aktivitetet e planifikuara AMS-ja i përcakton përmes miratimit të :

- Planit vjetor të punës,
- Planit vjetor për mbikëqyrje në terren,
- Planit financiar,
- Planit për prokurorime publike
- Planit për punën në arkiv,
- Planit vjetor të punësimeve
- Planit strategjik të punësimeve
- Planit strategjik për parandalimin e korrupsionit
- programe dhe dokumente të tjera relevante të fushës.

2.5. Auditimi i brendshëm

Aktiviteti i auditimit të brendshëm realizohet duke shfrytëzuar qasje sistematike, të disiplinuar dhe të bazuar në rreziqet. Kjo në vazhdimësi kontribuon në përmirësimin e proceseve të drejtimit, menaxhimit me rrezikun dhe mbajtjen e kontrolleve efektive në ballafaqimin me rreziqet, në raport me:

- Harmonizimin e ligjeve, dispozitave, procedurave dhe marrëveshjeve;
- Realizimin e qëllimeve strategjike;
- Efektivitetin dhe efikasitetin e punës së programeve;
- Besueshmërinë dhe integritetin e informacioneve financiare dhe operative;
- Mbrojtjen e fondeve.

2.6. Organizimi dhe financimi i AMS-së

Më 31.12.2022 numri i përgjithshëm i të punësuarve në AMS arriti 38.

Në përputhje me Rregulloren për organizimin e brendshëm të vendeve të punës, të punësuarit janë shpërndarë në 2 drejtori të pavarura, 2 vende të punës me titullin Këshilltar i Përgjithshëm, 3 shërbime profesionale dhe 9 drejtori në kuadër të shërbimeve profesionale.

Puna e AMS-së financohet nga kompensimet që i paguajnë subjektet e tregut që janë objekt kontrolli nga ana e AMS-së, siç janë shoqëritë e sigurimeve, shoqëritë e brokerimit në sigurime, shoqëritë për përfaqësim në sigurime, bankat të cilat ushtrojnë aktivitete të përfaqësimit në sigurime dhe personat e tjerë mbi të cilët AMS-ja kryen supervizion. Kompensimet janë të përcaktuara me “Listën e Tarifave për përmbajtjen dhe vlerën e kompensimeve dhe detyrimeve që i paguhen Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe për afatet e pagimit”, në përputhje me Ligjin e Mbikëqyrjes të Sigurimeve.

2.7.Përgjegjësia shoqërore korporative

AMS-ja është një institucion me përgjegjësi shoqërore, në punën e vet AMS-ja i respekton parimet e përgjegjësisë shoqërore korporative si përmbledhje të të gjitha pritjeve ekonomike, juridike, etike që shoqëria i ka ndaj subjekteve juridike.

Në këtë drejtim angazhohemi dhe:

- promovojmë partneritete për të mbështetur nxënësit, pjesëmarrjen e tyre në aktivitete, rritjen e ndërgjegjësimit për rreziqet dhe rolin e sigurimeve, informimin aktiv, promovimin e interesave të nxënësve,
- krijojmë mundësi për realizimin e vizitave studimore për nxënësit dhe studentët me qëllim të informimit aktiv të tyre;
- inkurajojmë vullnetarizmin, me qëllim përforcimin e ndërgjegjes për rëndësinë e të rinjve dhe rolin e tyre social.
- përkrahim aksione humanitare etj.
- promovojmë dhe ndërgjegjësojmë opinionin publik për profesionin aktuarial, i cili është një aktivitet me rëndësi thelbësore në sigurime;
- mbështesim dhe krijojmë programe arsimore për edukimin financiar;
- punojmë vazhdimisht për rritjen e frymës së ekipit tek punonjësit etj.

3. AKTIVITETE TË REALIZUARA NË PERIUDHËN E RAPORTIT SIPAS FUSHAVE

Funksionimi i AMS-së në vitin 2023 u zhvillua në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në kuadër të planifikimit vjetor dhe në pajtim me planet strategjike. Si arritje të veçanta në vitin 2023 do të veçonim: krijimin e kushteve për hyrje të investimeve të reja dhe dhënia e lehtë të punës të dy shoqërive të reja të sigurimeve, përmirësimi i vazhdueshëm i mbikëqyrjes off-site dhe vendosja e masave parandaluese dhe korigjuese; zbatimin e mbikëqyrjeve të planifikuara në terren; organizimin e trajnimeve dhe provimeve për përfaqësues dhe brokerë të sigurimeve; realizimin e trajnimit dhe provimit për aktuarët; procedurimi lidhur me ankesat e parashtruara nga të siguruarit, aktivitete në vazhdimësi lidhur me edukimin financiar dhe rritjen e ndërgjegjësimit për sigurimet dhe benifitet e sigurimit, miratimin e akteve të reja nënligjore dhe përmirësimin e akteve ekzistuese; zbatimin e detyrimeve të rregullta në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit me autoritetet mbikëqyrëse, miratimin e dokumentave strategjike dhe miratimin e strategjive me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar të sektorit, stimulimin e inovacioneve në

sektorin financiar, bashkëpunim dhe komunikim të rregullt me autoritetet dhe institucionet përkatëse.

Vijon elaborimi sipas fushave:

3.1. Rregullativa dhe Licencimi

Gjatë vitit 2023, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve së bashku me Ministrinë e Financave vazhduan punën për hartimin e Ligjit të ri të Sigurimeve në përputhje me dispozitat e Direktivës 2009/138/KE për krijimin dhe zbatimin e aktiviteteve të biznesit të sigurimeve dhe risigurimeve (Solvency II). Me ligjin e ri, krahas përputhshmërisë me Direktivën Solvency II (Aftësia paguese II), bëhet edhe respektimi i Direktivës së Shpërndarjes së Sigurimeve (Insurance Distribution Directive), duke marrë parasysh parimet e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, sipas të cilave mbikëqyrësit kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e ndërgjegjësimit të sigurimeve me fokus të veçantë Parimi 19 - ushtrimi i sigurimit (ICP 19 – Conduct of business) i cili normativizon shoqëritë e sigurimeve dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve që të zbatojnë trajtim të drejtë ndaj konsumatorëve jo vetëm kur blejnë kontratën e sigurimit, por edhe gjatë servisimit të kontratës dhe kur lindin detyrimet për kompensimin dhe pagesën e dëmeve, ndërsa Parimi 18 – Ndërmjetësimi në sigurime (ICP 18 – Intermediaries), normativizon ndërmjetësuesit e sigurimeve që të kryejnë rolin e tyre në mënyrë profesionale dhe transparente, pra thekson rolin e tyre në promovimin e besimit të opinionit publik në sektorin e sigurimeve dhe rolin e tyre në promovimin e ndërgjegjësimit financiar. Ligji rregullon edhe mënyrën e zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve të sigurimit në procedurë ndërmjetësimi. Gjithashtu parashikohet futja e një akti nënligjor që do të përcaktojë mënyrën dhe procedurën e zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve apo kontesteve.

Në varësi të procesit të miratimit të ligjit të ri të sigurimeve, AMS-ja do të përgatisë një plan me dinamikën e miratimit të akteve nënligjore që do të dalin nga ligji i ri i sigurimeve dhe do të masë burimet e nevojshme dhe dinamikën e miratimit të akteve të reja nënligjore.

3.2. Rregullore, udhëzime dhe manuale të miratuara

Bazuar në nevojën e konstatuar për përshkrimin më të detajuar të rregullave të reja dhe ofrimin e udhëzimeve, AMS-ja miratoi aktet nënligjore dhe dokumentet e mëposhtme:

1. Rregullore për përmbajtjen e raporteve që shoqëritë e përfaqësimit në sigurime, shoqëritë e brokerimit në sigurime dhe bankat i dorëzojnë në Agjencinë e Mbikëqyrjes të Sigurimeve dhe afatet dhe mënyrat e dorëzimit të tyre (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 108/2023);
2. Rregullore për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave nga shoqëritë e sigurimeve, shoqëritë e brokerimit në sigurime dhe shoqëritë e përfaqësimit në sigurime (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 174-2023);
3. Rregullore për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave nga brokerët e sigurimeve, shoqëritë e brokerimit në sigurime, përfaqësuesit në sigurime, shoqëritë e përfaqësimit në sigurime dhe bankat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 174-2023);

4. Rregullore për përshtatshmërinë e mbulimit të risigurimit, mënyrën e llogaritjes së vlerës së mbulimit maksimal të shoqërisë së sigurimit në tabelën maksimale të mbulimit dhe mënyrën e llogaritjes së dëmit maksimal të mundshëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 3/ 2024);

5. Udhëzim për bërjen e vlerësimit të rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit për subjektet nën mbikëqyrjen e Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 261/2023);

6. Manual për themelimin dhe funksionimin e një shoqërie të brokerimit në sigurime.

Gjatë kësaj periudhe, ne përcaktuam nevojën për ndryshime dhe plotësime në Rregulloren për kërkesat minimale për trajtimin, përpunimin, rezervimin dhe pagesën e kërkesave për dëmshpërblim të dëmit dhe/ose shumës së siguruar me qëllim mbrojtjen më të mirë të të drejtave të të siguruarve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 174/2023 dhe 223/2023). Ndryshimet synojnë forcimin e mbrojtjes së policëmbajtësve dhe përdoruesve të sigurimeve, me qëllim zgjidhjen efikase dhe efektive të kërkesave për dëmet.

3.1. Leje dhe dakordime të dhëna

Në bazë të kërkesave të pranara nga subjektet, AMS-ja jep lejet dhe dakordësitë e mëposhtme :

- 2 leje për shoqëri të sigurimeve (një shoqëri e re në fushën e sigurimeve jo-jetë dhe një për ushtrimin e sigurimeve të jetës)
- 3 leje për ushtrimin e veprimtarive të brokerimit në sigurime
- 2 leje për ushtrimin e veprimtarive të përfaqësimit në sigurime
- 1 leje për futjen e klasës së re të sigurimeve,
- 10 leje për aktuar të autorizuar
- 16 dakordësi për shoqëri të auditimit
- 8 dakordësi për ndryshimin e statutit
- 3 dakordësi për ndryshimin e selisë
- 22 dakordësi për ushtrimin e funksionit të organit drejtues në shoqërinë e sigurimeve dhe
- 4 dakordësi për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri të brokerimit në sigurime

Me rëndësi të veçantë është hyrja e dy kompanive të reja të sigurimeve, njëra në segmentin e sigurimeve jo-jetë e cila është në pronësi të plotë të investitorëve vendas, ndërsa e dyta në fushën e jetës është në pronësi të një grupi sigurimesh nga Sllovenia. Të dy kompanitë pritet të përmirësojnë konkurrencën në sektor dhe të kontribuojnë në pasurimin e ofertës së produkteve të sigurimit.

3.2. Licenca të dhëna

Në vitin 2023 në bazë të kërkesave të marra nga subjektet AMS-ja ka lëshuar 92 licenca për brokerë sigurimesh dhe 357 licenca për agentë/përfaqësues sigurimesh.

3.3. Licenca të revokuara

Në vitin aktual, për shkak të zgjidhjes së kontratave të punës me agentët apo përfaqësuesit në sigurim, AMS-ja ka revokuar 43 licenca të personave fizikë për agentë sigurimesh.

3.4. Trajnime të organizuara

Gjatë vitit 2023, Agjencia filloi trajnim të ri për aktuarë, që planifikohet të përfundojë në vitin 2025, ndërsa trajnimet për ndërmjetësues në sigurime zhvillohet konform orarve të planifikuara. Për trajnimin për përfaqësues kanë aplikuar gjithsej 321 kandidatë, nga të cilët 226 kandidatë janë pajisur me certifikatë për përfaqësim në sigurime. Për trajnimin për broker në sigurime aplikuan gjithsej 133 kandidatë, nga të cilët 99 kandidatë u pajisën me certifikatë për brokerim në sigurime.

4. ZBATIMI I MBIKËQYRJES

AMS-ja zbaton mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit në sigurime, shoqërive të përfaqësimit në sigurime dhe Byrosë Kombëtare të Sigurimeve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm në Transport dhe ligjeve dhe rregulloreve të tjera përkatëse.

AMS-ja e realizon mbikëqyrjen përmes mbikëqyrjes së përhershme off-site, pra mbledhjen, analizimin dhe verifikimin e raporteve dhe informacioneve të dorëzuara nga shoqëritë e sigurimit dhe persona të tjerë në përputhje me Ligjin, mbikëqyrjen në terren (të plotë ose të pjesshme) të veprimtarisë së shoqërive të sigurimeve (kontroll), si dhe mbikëqyrje shtesë sa herë që gjykohet se është në interes të mbrojtjes së të drejtave të të siguruarve dhe përcaktimit të masave të mbikëqyrjes. AMS-ja zbaton mbikëqyrjen edhe të personave fizikë që ushtrojnë aktivitetin e brokerimit dhe përfaqësimit në sigurime.

Në bazë të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, AMS-ja mbikëqyr zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4.1. Mbikëqyrje në terren

Për vitin 2023, mbikëqyrja në terren është zbatuar pa probleme dhe në përputhje me Planin vjetor të mbikëqyrjes në terren. Gjatë kësaj periudhe, AMS-ja ka realizuar 9 mbikëqyrje në terren, prej të cilave një mbikëqyrje të plotë, ndërsa të tjerat kanë qenë mbikëqyrje të pjesshme. Pesë nga

mbikëqyrjet në terren ishin në fushën e rakordimit të shoqërive të sigurimeve për sa i përket rregullave të vendosura nga AMS-ja në fushën e sistemeve të informacionit.

Në procedurën e mbikëqyrjes në terren janë konstatuar gjithsej 22 konstatime për mospërputhje ligjore dhe janë dhënë 41 rekomandime për përmirësimin e proceseve të brendshme të subjekteve të mbikëqyrjes dhe janë vendosur masat e mëposhtme mbikëqyrëse:

- 16 urdhra për eleminimin e paligjshmërive;
- 11 masa shtesë për eleminimin e paligjshmërive

Gjithashtu, AMS-ja ka shqiptuar 6 gjoba, të cilat janë realizuar me procedurën e barazimit/shlyerjes;

4.2. Mbikëqyrje off-site

Gjatë vitit 2023, në bazë të zbatimit të mbikëqyrjes off-site, AMS-ja ka hartuar 44 procesverbale, në të cilat ka konstatuar 52 konstatime për mosrakordime ligjore

Mbi bazën e procesverbaleve off-site u shqiptuan masat e mëposhtme të mbikëqyrjes:

- 5 urdhra për eleminimin e paligjshmërive;

Gjithashtu, AMS-ja ka shqiptuar 10 gjoba, të cilat janë realizuar me procedurën e barazimit/shlyerjes me parashtrimin e urdhërpagesës për kundërvajtje;

4.3. Pjesëmarrje në kolegjume pune

Gjatë vitit 2023, AMS-ja ka marrë pjesë rregullisht në të gjitha takimet e punës për shkëmbimin e rregullt të informacionit me organet mbikëqyrëse brenda kolegjeve mbikëqyrëse, për shoqëritë e sigurimeve që i përkasin grupeve evropiane të sigurimeve me seli jashtë vendit. Qëllimi i bashkëpunimit është njohja e mbikëqyrësve me trendet dhe rreziqet aktuale në tregjet e sigurimeve në të cilat janë anëtarë të shoqërive të sigurimeve, si dhe prioritetet e duhura të aktiviteteve të ardhshme mbikëqyrëse. Bashkëpunimi vlerësohet si cilësor për shkak të përpunimit dhe shkëmbimit në kohë dhe në mënyrë konfidenciale të informacionit mbi funksionimin e shoqërive të sigurimit - anëtarë të grupeve të sigurimeve.

4.4. Pikëpamje dhe qarkore

Në kuadër të veprimtarisë së saj dhe me qëllim sqarimin e detajuar të fushave të caktuara të funksionimit të subjekteve në tregun e sigurimit, AMS-ja si mjet shtesë ka praktikuar edhe shkresa qarkore përmes të cilave ka shprehur qëndrimin e saj dhe ka dhënë udhëzime apo rekomandime të caktuara në varësi të rrethanave. Gjithashtu në vazhdimësi kemi iniciuar takime profesionale dhe takime me përfaqësues nga industria e sigurimeve për të diskutuar çështje nga fusha e sigurimeve.

Në drejtim të zbatimit konsekuent të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm në Transport, akteve nënligjore të miratuara, por duke pasur parasysh detyrimet për respektimin e ligjeve të tjera përkatëse, ne kemi vepruar në mënyrë proaktive duke dhënë mendime, pikëpamje apo rekomandime për situata dhe çështje të caktuara.

5. BASHKËPUNIMI

Zbatimi i kompetencave të AMS-së, nevoja për të ndjekur trendet për nxitjen e rritjes dhe zhvillimit të tregut të sigurimeve kërkon bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm me autoritetet dhe organet rregullatore përkatëse vendase dhe të huaja, si dhe anëtarësimin në organizma dhe shoqata profesionale ndërkombëtare.

- Forcimi i bashkëpunimit të brendshëm është i rëndësishëm dhe lidhet me shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit dhe të dhënave, ofrimin e trajnimeve reciproke dhe shkëmbimin e përvojës.

Vazhdon bashkëpunimi me Ministrinë e Financave për çështjet që kanë të bëjnë me rregullativën në fushën e sigurimeve, pjesëmarrjen në grupe pune, propozimet për hartimin e ligjeve nga kjo fushë, pjesëmarrjen në organet profesionale si Këshilli i Zhvillimit të Kapitalit, strategjitë në fushën e ekonomisë dhe financave etj.

Në drejtim të rakordimit të legjislacionit vendas me atë evropian, AMS-ja i jep Sekretariatit për Çështje Ekonomike të dhëna për ecurinë e tregut të sigurimeve dhe përgatit raporte periodike për ecurinë e shtetit në sferën e sigurimeve dhe të mbikëqyrjes.

Bashkëpunimi me Bankën Popullore zhvillohet në disa segmente: shkëmbimi i të dhënave për përgatitjen e një raporti për stabilitetin financiar, pjesëmarrja në organet e ekspertëve, pjesëmarrja në komisione, aktivitetet për edukimin financiar dhe përfshirjen financiare, aktivitetet që lidhen me zhvillimin e sektorit fintek, shkëmbim i vazhdueshëm i përvojës dhe praktikave nga procesi i zbatimit të mbikëqyrjes etj.

- Memorandum bashkëpunimi

Me iniciativën tonë lidhëm memorandum bashkëpunimi me shoqëritë e sigurimeve, shoqëritë e brokerimit në sigurime dhe me Byronë Nacionale të Sigurimeve për të ndërmarrë aktivitete të përbashkëta në drejtim të forcimit të edukimit financiar të popullsisë dhe sigurimit të një shkalle më të madhe të përfshirjes financiare të çdo personi juridik apo personi fizik. Në këtë mënyrë do të promovohet rëndësia e sigurimit dhe përfitimet e tij. Qëllimi është që, me aktivitete të bashkërenduara bashkërisht, qytetarët të kuptojnë rëndësinë e sigurimeve, të perceptojnë rreziqet në jetën private dhe profesionale, të marrin informacion të plotë, të qartë dhe të krahësueshëm për kushtet dhe çmimet e sigurimit, si dhe për të drejtat e tyre nga kontratat e sigurimit. Të gjitha aktivitetet do të kontribuojnë në një përfshirje më të madhe financiare dhe një rritje të numrit të personave të siguruar.

Me qëllim të kontributit në edukimin formal dhe përmirësimin e aftësive të rinjve, AMS-ja ka lidhur memorandume bashkëpunimi me Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik, Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Lidhjen e Matematikanëve të Maqedonisë. Memorandumet përfshijnë aktivitete dhe projekte të shumta të përbashkëta për të mbështetur të rinjtë me theks të veçantë në edukimin e tyre financiar dhe përdorimin më të mirë të produkteve dhe shërbimeve financiare.

- Aktivitete të realizuara mbi bazën e dokumenteve strategjike të miratuara

Në mbledhjen e mbajtur në prill të vitit 2023, Komiteti për mbështetje të zhvillimit të inovacioneve në sistemin financiar (Komiteti për sektorin fintek) miratoi Strategjinë për Rregullatorët për Sektorin Fintek, e cila ka për qëllim të sigurojë kushte për mbështetjen e inovacioneve në fushën e financave, duke pasur parasysh mbrojtjen e konsumatorëve dhe investitorëve dhe stabilitetin e sistemit financiar.

Bazuar në Strategjinë e miratuar, grupi i punës për ngritjen e një qendre rregullatore të inovacionit ka mbajtur takime të rregullta me qëllim të konstatimit të nevojës për rregullativë të re ose plotësimin e rregullativës ekzistuese, zhvillimin e portalit të inovacionit financiar, miratimin e procedurave për punën e qendrës rregullatore të inovacionit, duke hartuar një fjalorth termash nga fusha e fintekut etj.

Në mbledhjen e Komitetit të Stabilitet Financiar, u miratua Strategjia e Zbatimit të Politikës Makroprudenciale, e hartuar nga Banka Popullore, në konsultë me rregullatorët e tjerë financiarë, në pajtim me Ligjin e ri të Stabilitetit Financiar. Strategjia forcon qasjen e koordinuar të rregullatorëve financiarë për forcimin e mëtejshëm të stabilitetit financiar. Në Komitet u vu në dukje përkushtimi i rregullatorëve për vazhdimin dhe forcimin e aktiviteteve të integritetit evropian, dhe në këtë kuadër u theksua edhe nevoja për të përfunduar procesin e nxjerrjes së disa ligjeve sistematike nga sfera financiare që do të kontribuojnë në ruajtjen dhe forcimin e mëtejshëm të stabilitetit financiar.

Bazuar në Strategjinë, Komiteti i Stabilitetit Financiar, në përbërje të të cilit është edhe Kryetari i Këshillit të Ekspertëve të AMS-së, në seancën e mbajtur në nëntor, u prezantua Raporti i Stabilitetit Financiar dhe u shqyrtuan treguesit për segmente të ndryshme të sektorit financiar, duke theksuar se stabiliteti financiar është ruajtur me sukses pavarësisht kushteve komplekse të funksionimit të sistemit financiar.

Gjatë kësaj periudhe AMS-ja ka miratuar Metodologjinë për zbatimin e mbikëqyrjes makroprudenciale dhe zbatimin e instrumenteve dhe masave makroprudenciale të sektorit të sigurimeve.

Në dhjetor u mbajt takimi i pestë i punës i Grupit të Punës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Edukimin Financiar dhe Përfshirjen Financiare, organizuar nga Trupi Koordinues i Rregullatorëve Financiarë për Edukimin Financiar dhe Përfshirjen Financiare. Në takim, përveç përfaqësuesve të autoriteteve rregullatore, ishin të ftuar edhe subjekte nga sektori privat dhe civil. Qëllimi i takimit ishte të mundësojë dialog të rregullt ndërmjet rregullatorëve financiarë, subjekteve nga sektori privat dhe civil të përfshirë në aktivitetet e edukimit financiar, si dhe shkëmbimin e propozimeve dhe përvojave për forcimin e përfshirjes financiare dhe mbrojtjes së konsumatorëve në sistemin financiar, për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë për Edukimin Financiar dhe Përfshirjen Financiare.

Gjatë vitit kalendarik, kemi qenë të pranishëm rregullisht në seancat e Trupit Koordinues për Edukimin Financiar dhe Përfshirjen Financiare, i cili përfshin përfaqësues nga të gjithë rregullatorët financiarë. Në këto korniza është iniciuar bashkëpunimi me Byronë për Zhvillimin e Arsimit, duke qenë se bëhet fjalë për aktivitete edukative në fushën e financave, duke përfshirë edhe popullatën e re që është ende brenda sistemit arsimor. Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në fushën e edukimit financiar, u mbajt një takim i përbashkët i Trupit Koordinues dhe përfaqësuesve nga Byroja, në të cilin u diskutuan mundësitë e zbatimit të aktiviteteve të mëtejshme për studimin e edukimit financiar në procesin arsimor përmes një lënde të veçantë ose duke përfshirë segmente të veçanta në lëndët ekzistuese (që është pjesërisht e pranishme në kushtet ekzistuese) në arsimin fillor dhe atë të mesëm.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, AMS-ja kontribuoi me pjesëmarrjen e saj gjatë misionit të vlerësimit në vitin 2023, i cili u krye nga Komiteti i Ekspertëve MONEYVAL i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, për të vlerësuar shkallën e gatishmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Komiteti i ekspertëve "Manival" vlerësoi se sistemi i licencimit dhe mbikëqyrjes së Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ASO) është përmirësuar ndjeshëm dhe i përmbush standardet ndërkombëtare për luftën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në Raport theksohet rëndësia e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, si dhe bashkëpunimin me autoritetet kompetente shtetërore. Kontribut të rëndësishëm në vlerësimin pozitiv kanë edhe aktet, analizat dhe vlerësimet e miratuara

nga AMS-ja dhe trajnimet e kryera për rritjen e efikasitetit në funksionimin e shoqërive të sigurimit dhe ndërmjetësve që shesin policat e sigurimit të jetës.

- **AMS-ja ruan dhe forcon vazhdimisht marrëdhëniet e krijuara të partneritetit me organet rregullatore të huaja dhe institucionet përkatëse të fushës me qëllim shkëmbimin e përvojës dhe zhvillimin e praktikave të mira.**
- **AMS-ja është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) që nga viti 2009. IAIS është një institucion ndërkombëtar me mision promovimin e një mbikëqyrjeje efektive dhe të qëndrueshme globalisht, me qëllim sigurimin e zhvillimit të mëtejshëm të tregut global të sigurimeve, ruajtjen e një tregu korrekt, të qëndrueshëm dhe transparent në dobi dhe mbrojtje të të siguruarve dhe për të kontribuar në qëndrueshmërinë financiare.**

Brenda këtyre kornizave, ne kemi kryer një vetë-vlerësim të punës sonë në drejtim të zbatimit të parimit të Menaxhimit të Riskut për Qëllime të Aftësisë Paguese (Peer Review Process on the Enterprise Risk Management for Solvency Purposes ICP 16).

6. ORGANIZIMI I EVENTEVE

Tradicionalisht, në vitin 2023, AMS-ja e shënoi Ditën Kombëtare të Sigurimeve, 1 Nëntorin, si dhe 14 vjet punë të suksesshme si organ i pavarur rregullator përgjegjës për tregun e sigurimeve. Në kuadër të aktivitetit u mbajt një panel diskutimi me titull “Si ta shndërrojmë rritjen e sigurimeve në zhvillim”. Me këtë rast përfaqësues të industrisë së sigurimeve, AMS-së, Ministrisë së Financave dhe Odës Ekonomike debatuan për ligjin e ri të sigurimeve, si dhe shkëmbyen mendime për procesin e liberalizimit të sigurimit të makinave dhe kartonit jeshil, si dhe për rëndësinë e pranimit cilësor të dëmeve në sigurimin e jetës.

Në Ditën e Sigurimeve, katërmëdhjetë kompani të sigurimeve në koordinim me AMS-në, ndanë bursa për studentë – matematikanë të Fakultetit të Shkencave Natyrore të Matematikës në Universitetin e “Shën Cirilit dhe Metodij” në Shkup. Bëhet fjalë për studentë me mesatare të lartë në lëndët aktuariale dhe matematikore në Fakultetin e Shkencave dhe Matematikës (FSHNM) të cilët përkundër burës do të kenë mundësinë për t’u praktikuar në kompanitë e sigurimeve. Synimi është promovimi, ndërgjegjësimi dhe afirmimi në publik i profesionit të aktuarit, që është një veprimtari me rëndësi thelbësore në sigurime dhe në të njëjtën kohë një profesion shumë i vlerësuar dhe mirë i paguar. Studentët e departamenteve të matematikës të FSHNM-së janë aktuarë potencialë, të cilët pas përfundimit të trajnimit përkatës të organizuar nga AMS-ja, mund të bëhen aktuarë të autorizuar. Dhe më pas mund të punësohen në kompanitë e sigurimeve, kompanitë e menaxhimit të fondeve të pensioneve, banka dhe institucione të tjera financiare.

Në kuadër të këtij eventi, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka dhënë certifikata për 14 persona - të cilët kanë përfunduar me sukses trajnimin dyvjeçar për aktuarë dhe kanë marrë provimet në të 15 lëndët profesionale. Nën specialiteti i tyre është krijimi i modeleve matematikore për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve që marrin shoqëritë e sigurimeve. Trajnimi për titullin aktuar i autorizuar zgjati dy vjet dhe filloi në vitin 2021.

Me rastin e Ditës së Sigurimeve, AMS-ja ndau edhe çmimin e studiuesit të ri për punimin më të mirë shkencor në fushën e menaxhimit të riskut dhe sigurimit. Për të pranishmit u prezantua punimi me titull “Trendet në përqendrimin e tregjeve të sigurimeve në Evropën Lindore”.

Në kuadër të aktivitetit "Ditët e Edukimit Financiar 2023", AMS-ja ndau çmime dhe fletëlavdërime 37 nxënës, nga shkollat fillore dhe të mesme në të gjithë vendin, për vizatime, ese dhe poezi me tema sigurimesh. Për një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e edukimit financiar të nxënësit, AMS-ja ndau edhe mirënjohje për 20 mësues - mentorë, të cilët vazhdimisht dhe me përkushtim punojnë me nxënësit për ndërgjegjësimin për rëndësinë e sigurimit për mirëqenien e përgjithshme të popullatës.

Në përputhje me praktikën e krijuar dhe bashkëpunimin e mirë me Shoqatën e Bankave të Maqedonisë në drejtim të rritjes së edukimit financiar të nxënësit e moshës 13-15 vjeç, AMS-ja çdo vit e mbështet eventin "Kuizi evropian i parasë", për të cilin përgatit pyetje dhe materiale edukative dhe informacione nga fusha e sigurimeve dhe menaxhimit të riskut.

7. EDUKIMI DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE

AMS-ja, parimet bazë të politikës së cilësisë i bazon në qëllimet e përmirësimit të kapaciteteve institucionale dhe administrative, duke investuar të punonjësit përmes trajnimeve dhe zhvillimit profesional. Trajnimi i personelit është një parakusht për kryerjen efikase, cilësore dhe në kohë të punëve dhe detyrave në kompetencë të AMS-së dhe për këtë arsye vazhdimisht investohet në potencialin e saj njerëzor.

Në vitin 2023, të punësuarit i realizuan me sukses trajnimet e planifikuara dhe u realizuan edhe vizita tematike tek rregullatorët e huaj, pjesëmarrje në konferenca dhe seminare brenda vendit dhe jashtë vendit për rritjen e kualifikimeve dhe njohurive të të punësuarve. U realizuan edhe programe edukative, seminare përmes Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), Organizatës Evropiane të Mbikëqyrjes (EIOPA), Bankës së Rregullimeve Ndërkombëtare (BIS), Rrjetit Ndërkombëtar të Edukimit dhe Trajnimit Financiar (OECD-INFE), Institutit për ndërtimin e kapaciteteve pranë Fondit Ndërkombëtar Monetar në bashkëpunim me Joint Vienna Institute dhe institucione dhe organizata të tjera relevante.

8. MBROJTA E KONSUMATORËVE, EDUKIMI FINANCIAR DHE PËRFSHIRJA FINANCIARE

Objektivat bazë të AMS-së në lidhje me stabilitetin dhe zhvillimin e tregut të sigurimeve dhe monitorimin e ligjshmërisë së veprimeve të subjekteve që i nënshtrohen mbikëqyrjes lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e të siguarve dhe përdoruesve të produkteve dhe shërbimeve të sigurimit. Në këtë segment, AMS-ja ka kryer aktivitete të vazhdueshme dhe ka vepruar në mënyrë të integruar në disa nivele:

- ✓ zbatimin e mbikëqyrjes së subjekteve të sigurimeve për t'u siguruar që ato janë në përputhje me ligjet përkatëse;
- ✓ edukimin e policëmbajtësve duke zhvilluar ndërgjegjësimin për rreziqet që lidhen me investimin në sigurime, duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga sigurimet; dhe
- ✓ procedurimin e ankesave të marra nga personat e siguar, përfituesit e sigurimeve dhe personat e dëmtuar nga palët e treta.

Me shumë vëmendje dhe përkushtim punojmë për ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe forcimin e perceptimit të institutit të Ankesave, si një e drejtë mbrojtjeje që ka çdo i siguar kur vlerëson se cilësia e produktit, shërbimit dhe sjelljes nga ana e shoqërisë të sigurimeve nuk janë në nivel

profesional. Për ne, procesi i trajtimit apo procedurimit të ankesave është një mjet i rëndësishëm për mbrojtjen e të siguarve dhe ndërgjegjësimin për të drejtat e tyre, dhe si barometër tregu për cilësinë e produkteve të sigurimit, ankesat janë sfida dhe provokimi ynë për të ndërmarrë më tej aktivitete kontrolli me qëllimin e vetëm sigurimin e trajtimit dhe mbrojtjes së drejtë të të siguarve.

Në vitin 2023, AMS-ja ka pranuar një numër më të madh ankesash krahasuar me vitin paraprak. Gjegjësisht, gjithsej 285 ankesa kanë arritur në adresën tonë dhe janë shqyrtuar. Kjo e dhënë është një tregues i qartë se qytetarët e njohin gjithnjë e më shumë rolin tonë si mbrojtës të të drejtave dhe interesave të tyre nga sigurimet, i cili mbetet prioriteti dhe angazhimi ynë i përhershëm.

Në kuadër të misionit të saj, AMS-ja si rregullator i pavarur i tregut të sigurimeve zhvillon vazhdimisht ndërgjegjësimin dhe perceptimin e sigurimeve si interes publik i të gjithë shoqërisë.

Në vazhdimësi elaborojmë aktivitetet tona:

Në drejtim të plotësimit të arsimit formal, AMS-ja vazhdimisht ka një thirrje të hapur për shkollat fillore, të mesme, fakultetet, në mënyrë që të na kontaktojnë nëse dëshirojnë t'u ofrojnë nxënësve/studentëve të tyre leksione për lëndën e edukimit financiar dhe edukimit në fushën e sigurimeve. Ndërsa në kuadër të memorandumëve të nënshkruara me institucionet arsimore, AMS-ja është gjithmonë në dispozicion për të kryer edukimin dhe për të ofruar vizita studimore për studentët dhe nxënësit.

Portali edukativ, <https://edukacija.aso.mk/financeniska-edukacija>, është një mjet i rëndësishëm për komunikim me publikun që afron botën e sigurimeve me konsumatorët. Portali përmban materiale edukative dhe informacione nga fusha e sigurimeve, analiza dhe të dhëna për subjektet e tregut, dokumente strategjike, sqarime termash nga fusha e sigurimeve etj. Nëpërmjet portalit personat e siguar kanë mundësi të parashtrajnë ankesë elektronike, si dhe ka mundësi të bëjnë pyetje.

Fokusi i aktiviteteve tona është promovimi i vazhdueshëm i praktikave të mira në fushën e edukimit financiar dhe promovimi i rolit të shoqërive të sigurimit dhe ndërmjetësve të sigurimeve në edukimin financiar të konsumatorëve dhe të policëmbajtësve të tyre, në mënyrë që të bëhen pjesë e performancës së mirë të tyre korporative.

Gjatë vitit janë realizuar disa aktivitete për edukimin financiar me qëllim të rritjes së edukimit financiar të popullatës (maj - muaji i edukimit financiar, ditët e edukimit financiar, java globale e parave, 15 Marsi - Dita Botërore e të Drejtave të Konsumatorit), realizimi i mësimdhënies praktike për nxënës dhe studentë, si dhe projekte me interes të ndërsjellë dhe mundësi për bursa studentore, intervista përmes mediave të shkruara, disa ftesa televizive për tema aktuale të zonës. Gjithashtu, përmes rrjeteve sociale (Facebook, Instagram, LinkedIn) ASO publikoi përmbajtje të shumta edukative me informacione të dedikuara për të gjitha kategoritë e popullsisë (individë, familje, sektori i biznesit).

Për të nxitur mendimin shkencor dhe për të kontribuar në rritjen e numrit dhe cilësisë së punimeve shkencore të aplikuara në fushën e menaxhimit të riskut dhe sigurimit, AMS-ja shpall çdo vit konkurs për një punim kërkimor në fushën e menaxhimit të riskut dhe sigurimit. Ndërsa në drejtim të ndërgjegjësimin të të rinjve për rëndësinë e sigurimeve, AMS-ja shpall konkurs vjetor për vepër letrare dhe artistike me temën e sigurimit, për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm.

9. AKTIVITETE PROJEKTUESE

Në vitin 2023, vazhdoi faza e dytë e projektit rajonal, nën përkujdesin e Ministrisë së Financave të Holandës dhe Rrjetit Ndërkombëtar për Edukimin Financiar (INFE-OECD). Projekti mbulon një periudhë pesëvjeçare, 2023-2027, me theks në forcimin e kapaciteteve të rregullatorëve të tregut financiar me qëllim promovimin e rëndësisë së edukimit financiar, rritjen e nivelit të edukimit financiar tek popullata dhe rritjen e shkallës së përfshirjes financiare. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, përmes shkëmbimit të përvojave dhe njohurive, do të përgatiten analiza, raporte dhe rekomandime në drejtim të ngritjes së kapaciteteve sipas nevojave institucionale dhe përcaktimeve strategjike të vendit.

Aktivitetet në kuadër të EUROPA RE - projekti rajonal për mbrojtjen nga rreziqet katastrofike dhe katastrofat natyrore, lidhur me zhvillimin dhe vendosjen e një sistemi gjithëpërfshirës kombëtar të sigurimeve bujqësore në të cilin merr pjesë AMS-ja, vazhduan edhe në vitin 2023 përmes përgatitjes së Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm Bujqësor. Koncepti i ri i sigurimeve bujqësore që operohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave parashikon ngritjen e një puli sigurimesh, qëllimi i të cilit do të jetë siguri i prodhimit bujqësor të të gjithë fermerëve. Përparësi do të jetë edhe fakti se fermerët do të marrin pagesën për dëmin e shkaktuar gjatë të njëjtit vit në të cilin ai ka ndodhur.

Ky projekt është me rëndësi strategjike sepse ofron një zgjidhje sistematike të qëndrueshme për sigurimin bujqësor. Qëllimi përfundimtar i projektit është që sigurimet bujqësore të bëhen të vetëqëndrueshme për një periudhë të caktuar, të kenë potencial për rritje dhe zhvillim në mënyrë që të tre palët e përfshira, pra partnerët, të jenë të kënaqur: fermerët si përfitues, shoqëritë e sigurimeve si ofrues të shërbimeve dhe shteti si mbështetës. Suksesi i këtij projekti tani është i një rëndësie të veçantë dhe thelbësore për shkak të ndikimit negativ gjithnjë e më të pranishëm të ndryshimeve klimatike në prodhimin bujqësor. Kjo çështje për AMS-në si rregullator i tregut të sigurimeve është veçanërisht e rëndësishme sepse ofron një zgjidhje masive që do të çojë në forcimin e kulturës së sigurimit tek fermerët që janë një popullsi e madhe. Në hartimin e ligjit u konsultuan edhe përfaqësuesit e fermerëve, ku morën pjesë edhe shoqëritë e sigurimeve. Reagimet e fermerëve në përgjithësi janë pozitive.

10. INFORMIMI I PUBLIKUT DHE TRANSPARENCA

Në bazë të Ligjit për Akses të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve, AMS-ja vepron në pajtim me afatet e përcaktuara ligjore.

Me qëllim të transmetimit në kohë të informacionit dhe forcimit të praktikave të komunikimit me të gjitha palët relevante, AMS-ja vepron përmes faqes së internetit, portalit edukativ, rrjeteve sociale, përmes takimeve publike konsultative sipas nevojës dhe raportimit për progresin në lidhje me aktivitetet dhe projektet e AMS-së.

Për të rritur cilësinë e punës së saj, AMS-ja mat kënaqshmërinë e palëve të interesuara – klientëve, përmes sondazheve apo anketave elektronike dhe përmes mekanizmit të parashtrimit me shkrim të ankesave apo lavdërimeve nga përdoruesit e shërbimeve.

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve

Dr. Krste Shajnoski

Numri

Shkup më:06.2024